



REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org.Jedinica Org.Unit	SP-02
Nr. i Fajevë Br. Stranica No. Pages	- 05 -
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	553-2/24
Data Datum Date	09.09.24
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	12.08.2024
REFERENC-Ë:	24/553/MMPHI
PËR/ZA/TO:	N.T.P. "Unio - Commerce" Sh.p.k. Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar, Doganaj, Kaçanik
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për refuzimin e kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, të operatorit N.T.P. "Unio - Commerce" Sh.p.k. me nr.prot. 24/553/MMPHI, për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/553/MMPHI
Datë: 12.08.2024.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenin 7, paragrafi 5 të Ligjit Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes , nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit N.T.P. "Unio-Commerce" Sh.p.k. i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar, Doganaj, Kaçanik, në ngastrat kadastrale nr.00534-0, 00534-2, 00541-0, 00542-0, 00547-0, 00548-2, 00546-0, 00543-1, 00545, 00544-0, 00540-1, zona kadastrale Doganaj, Kaçanik, sipas Vendimit të Pëlqimit Mjedisor.



A r s y e t i m

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar të operatorit N.T.P. "Unio-Commerce" Sh.p.k. për veprimtarinë: Fabrikë për prodhimin e bllokave të lehtë të autoklavizuar.

Kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Integruar, operatori i ka bashkangjitur dokumentacionin si në vijim:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, të lëshuar nga MTI;
- Aplikacionin për Leje Mjedisore të Integruar;

MMPHI, ka realizuar vizitë te operatori për verifikimin e kushteve mjedisore me datë: 19.04.2024.

MMPHI, pas realizimit të vizitës në teren, përmes e-mailit të dërguar me datë: 25.04.2024, ka kërkuar nga kompania plotësimin e dokumentacionit dhe kushteve të cekura më poshtë:

1. Aplikacioni të riplotësohet në përputhje me gjendjen në teren;
2. Seperacioni i rërës nuk është aktiv dhe për këtë duhet të futet në funksion, nëse kërkon të vazhdohet me procedurat e shqyrtimit;
3. Leje për aktivitete të veçanta nga KPMM për seperacionin e rërës;
4. Kontrate me kompaninë që ju furnizon me rërë kuarci;
5. Pompa e derivateve nuk është aktive dhe për këtë duhet të futet në funksion, nëse kërkon të vazhdohet me procedurat e shqyrtimit;
6. Pëlqim nga Agjencia e Menaxhimit Emergjent(AME) për pompën e derivateve (Rezervuari i naftës);
7. Mulliri i gëlqeres nuk është aktiv dhe për këtë duhet të futet në funksion, nëse kërkon të vazhdohet me procedurat e shqyrtimit;
8. Kontratë me kompaninë që ju furnizon me gëlqere;
9. Kaldaja
 - Lënda djegëse, atesti i lëndës djegëse;
 - Dokument (Licence ose autorizim) për operim për enët nën shtypje;
 - Sistemi për depluhurim;
 - Pëlqim nga AME;
10. Autoklavat 1,2,3,4,5,6 (Siguria teknike pajisjeve nën presion):



- Pajisje paralajmëruese që dërgojnë një sinjal drite ose zani.
- Pajisjet përcjellëse(ventilet sigurues, enët e kondenzatit, termometrat, manometrat etj.);
- Dokument (Licence ose autorizim) për operim për enët nën shtypje për secilën autoklavë (1,2,3,4,5,6) ;

11. Kompresori i ajrit dhe pajisjet përcjellëse

- Dokument (Licencë ose autorizim) për operim për enët nën shtypje-kompresori;
- Dokument (Licence ose autorizim) për operim për enët nën shtypje-rezervuari i ajrit;

12. Ajri:

- Pluhuri nga oxhaku i mullirit të gëlqeres;
- Pluhuri nga oxhaku i kaldajës;
- Emisionet ne ajër nga oxhaku i kaldajës (NOx; SO₂; CO, , etj.)
- PM 2.5; PM 10;
- Pluhuri total i depozituar;
- Pluhuri (filtrat te hambari ditor dhe javor).

13. Ujërat:

- Pikat e shkarkimeve;
- Sistemi për trajtim te ujerave shkarkues nga procesi teknologjik;
- Sistemi për trajtim te ujerave nga sipërfaqja operationale;
- Leja ujore për shkarkim.

14. Mbeturinat:

- Sasia e mbeturinave dhe lloji i mbeturinave(nga procesi teknologjik, hedhurinat etj);
- Kontrate me kompaninë e për grumbullimin e mbeturinave përfshirë edhe nga procesi teknologjik;
- Kontrate me kompaninë qe posedon Leje për grumbullimin/reciklim te vajrave mbeturinë.

15. Certificate ISO 14001:2015 (International standart- Sistemi i menaxhimit te mjedisit-SMS) Certifikata EMS-2015, dhe linku IAF certifikata;

16. Planin e vet monitorimi- te plotësohet nga operatori;

17. Pagesën tarifës për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore te Integruar sipas Udhëzimit Administrativ Nr.13/2015;



Pas shqyrtimit të kërkesës të operatorit në fjalë, duke përfshirë aplikacionin, dokumentacionin shtesë të dërguar që nevojitet për pajisje me Leje Mjedisore të Integruar dhe gjendjes faktike në teren, konstaton se dokumentacioni i dërguar nga operatori me datë: 21.06.2024, nuk është i kompletuar.

Andaj në përputhje me Ligjin Nr.08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, MMPHI merre **Vendim që operatorit të lartcekur t'i refuzohet kërkesa për t'u pajisur me Leje Mjedisore të Inegruar.**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimet të këtij vendimi.



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Kaçanik;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së